



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.850/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e votueses Fexhrije Bislimi nga Gjilani, paraqitur kundër vendimit me nr.2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021 për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** i pabazuar apeli Anr.850/2021 i datës 04.11.2021, i paraqitur nga Fexhrije Bislimi, nga Gjilani, me anë të së cilës ka kërkuar rinumërim të votave në qendrën e votimit 0428D, për shkak të mos përfshirjes së votës të saj në rezultatin përfundimtar të publikuar nga KQZ-ja .

## A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.850/2021 të paraqitur nga Fexhrije Bislimi, votuese nga Gjilani, me të cilën pretendon se në qendrën e votimit 0428D ka votuar subjektin politik me numrin 121 dhe kandidatin me nr.10, por vota e saj nuk figuron në rezultatin përfundimtar të KQZ.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se apeli i parashtruar nga Fexhrije Bislimi, votuese ne Gjilani, me të cilën kërkon rinumërim të votave në qendrën e votimit 0428D1, është i pa bazuar. Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara siç pretendon në apelin e paraqitur, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, e në rastin konkret, paneli gjeti se pretendimet e apellesit nuk janë mbështetur në prova dhe fakte konkret por janë vetëm pretendime të supozuara dhe se këto pretendime për Panelin nuk janë të pranueshme.

Andaj, Paneli vlerësoi se apeli, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, i njëjti më tepër mbështetet në deklaratimet e vet apeluesses, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidatin.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Anr.850/2021 më datën 06.11.2021**

**Kryesues i Panelit**  
**Ferki Xhaferi**



***Këshilla Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.